

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me kryetaren e trupit gjykues Valbona Musliu-Selimaj dhe sekretaren juridike, Lindita Sylejmani, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.A, për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.8/2018 të 27.03.2018, e precizuar në seancë datë 18.04.2018, në seancën e shqyrtimit fillestar të hapur, të mbajtur me dt.18.04.2018, në praninë e prokurorit të shtetit, Hivzi Sylejmani, të akuzuarit F.A dhe mbrojtësit të tij av. B.E, në bazë të nenit 366 të KPPK-së, pas dy ditësh me dt.**20.04.2018**, morri dhe publikisht shpalli, këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari: F.A**, nga babai R. dhe nëna F. e gjinisë G, i lindur me..., në Fshatin K, KK P. ku edhe jeton, merret me blegtori, i martuar, baba i dy fëmijëve, gjendjes se dobët ekonomike, me numër personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak nga dt.15.01.2018 deri me datë 20.04.2018

### Ë S H T Ë F A J T O R

**SEPSE:** Me datë 15.01.2018 rreth orës 01:10, në fshatin Keqekollë, Komuna e Prishtinës, i akuzuari F.A, në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese ka përdorur armën e zjarrit pistoletën e tipit "TT M57", me numër serik C-210863, të kalibrit 7.62 mm, të cilën e ka poseduar në kundërshtim me ligjin mbi armët, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari A. e nis automjetin e tij dhe pasi largohet 15-20 metra, i akuzuari nxjerr revolen e lartcekur duke shtënë 2-3 herë në drejtim të të dëmtuarit dhe predha e godet automjetin në pjesën e mbrapme në brendësi të automjetit ku ishin edhe të dëmtuarat V.B dhe D.B,-

- me këtë ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 17; 21; 41; 42; 43; 46; 62; 69; 73; 74; 75; 76 par.1 nenpar.1.4 të KPRK-së dhe 83 të KPRK-së dhe neneve 248; 359; 365 dhe 366 të KPPK-së të akuzuarin e gjykon:

### D Ë N I M M E B U R G I M D H E M E G J O B Ë

- Me dënim me **Burgim** në kohëzgjatje prej 3 muaj në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 15.01.2018 deri me datë 20.04.2018 si dhe

- Dënim me **Gjobë**, në shumë prej një pesëqind Euro (500 €) të cilën gjobë obligohet ta paguajë në afatin prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë, nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutojë duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 € të gjobës si dhe

## DËNIM PLOTËSUES

- Konfiskohen përgjithmonë sendet e luajtshme, si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale dhe sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit dhe atë :
- arma pistoletë e tipit “TT M57”, me numër serik C-210863 të kalibrit 7.62 mm, një karikator i zbrazët dhe shtatë (7) fishekë
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të dëmtuarit: A.E, nga P, lagja B.D, zona Q., llam., nr., D.B, nga P., rruga “T”, pn., dhe V.B, nga P., rruga “M.P”, pa nr., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Me aktvendim të veçantë PKR.nr.80/18, të datës 20.04.2018, të akuzuarit i është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak dhe arsyet për ndërprerjen e masës janë dhënë në aktvendimin me shkrim.

## A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP/I.nr.8/2018, të dt.27.03.2018, ka akuzuarin F.A, për shkak të veprave penale Vrasje e Rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.5 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.04.2018, ku prezantuan Prokurori i shtetit, Hivzi Bajraktari, i akuzuari F.A me mbrojtësin e tij av. B.E sipas autorizimit.

Prokurori i shtetit në fillim të seancës, i dorëzoi gjykatës një kopje të aktakuzës së precizuar PP.I.nr.8/2018, dt.27.03.2018, dhe deklaroi se ka mbetur gabim teknik te data 27.03.2018 dhe se duhet të jetë data 18.04.2018 e që menjëherë pas leximit të aktakuzës së precizuar dhe me rikualifikim juridik, për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, të akuzuarit iu dha mundësia e deklarimit lidhur me aktakuzën, i cili deklaroi se e ka të qartë aktakuzën dhe e pranon fajësinë, u deklarua fajtor i veprës penale.

I akuzuari F.A pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij e duke i ditur pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë, e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së rikualifikuar, të cilin pranim e bëri me vullnet të plotë të plotë dhe pa presion, shprehu keqardhje, u ndie thellë i penduar, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin e po ashtu kërkoi dënim sa më të butë duke premtuar se asnjëherë nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme.

Mbrojtësi i të akuzuarit, F.A av. B.E, deklaroi se e mbështet në tërësi pranimin e fajësisë së të mbrojturit të tij, duke theksuar se pas konsultave dhe sqarimit lidhur me dorëzimin e aktakuzës së re nga prokurori i shtetit, i mbrojturi i tij e pranoi fajësinë duke pasur parasysh që pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar ka benefite që janë paraparë me ligj dhe është udhëzuar që në këtë stad ta pranoi fajësinë me të vetmin qëllim që të arrihen benefitet që i parasheh ligji,

duke pasur parasysh faktin se pranimi i fajësisë njihet si kurora e provave luti gjykatën që me rastin e matjes së dënimit, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, si faktin se i mbrojturi i tij ka qenë në shtëpinë e tij, ka qenë mesnatë, një muaj para datës kritike ka qenë i dëmtuar ku ka edhe rast të hapur në Prokurori si palë e dëmtuar pasi që i janë vjedhur bagëtitë, i njëjti merret me blegtori dhe është mbajtës i familjes, i dy fëmijëve dhe i prindërve të shtyrë në moshë. Prindi i tij me datë 16.04.2018 ka pasur edhe një intervenim në zemër por i njëjti ka respektuar masën e arrestit shtëpiak dhe nuk ka dalë nga shtëpia për të vetmin qëllim për ti dëshmuar gjykatës se çdo vendim të saj do ta respektojë me përpikëri, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtit ti shqiptojë një dënim me kusht sepse edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, është penduar thellë dhe se pendimi i tij është garanci e fortë se në të ardhmen asnjëherë nuk do të bie në kundërshtim me ligjin.

Konform nenit 248 par.2 të KPPK-së, prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari F.A për veprën penale si në aktakuzë ngase pranimi i fajësisë është në përputhje me nenin 248 të KPP-së dhe në përputhje të plotë me aktakuzën e cila është e bazuar në prova dhe shkresat tjera të lëndës, andaj i propozon gjykatës që të aprovoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari i lartë cekur.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari, gjykata konform nenit 248 par. 4 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë të akuzuarit, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk administroj prova por vlerësoi se në veprimet e të akuzuarit F.A ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, Përdorimi i armës apo njetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së e të cilën i akuzuari e ka kryer me dashje.

Me rastin e matjes dhe shqyrtimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij për veprën e kryer penale, premtimin se nuk do të përsëris apo nuk do të kryejë ndonjë vepër penale, sinqeritetin e tij deklarues, që për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj edhe të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i shqiptuar dënimin nën kufirin e paraparë ligjor për këtë vepër penale e duke aplikuar dispozitat ligjore për zbutjen e dënimit nga neni 76 par.1 nënpar.1.5, ku parashihet se nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim, si dhe dënimin me gjobë duke pasur parasysh edhe gjendjen e tij ekonomike, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit sipas nenit 73 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e të akuzuarit, si dhe do të ndikojnë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e arrestit shtëpiak në dënimin me burgim është marrë në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 62 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6, nenit 69 dhe 375 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe 453 par 1 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi ndërprerjen e masës së arrestit shtëpiak është marrë bazë të nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.80/18, dt.20.04.2018**

Procesmbajtëse:  
Lindita Sylejmani

Kryetare e trupit gjykues:  
Valbona Musliu-Selimaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura, kanë të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.